



## Titulli i projektit

Asistencë për inventarizimin dhe konsolidimin e asetëve dhe financave të ZF

## Tipi i projektit

Quick start, Manaxhim i Zonës Funksionale

## Vendndodhja e projektit

Qendra e ZF

## Buxheti i paravlerësuar

20,000 Euro

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/ëve

Njësia e re administrative, përfaqësuese e Zonës së re Funksionale, do të përballet menjëherë me sfidën e identifikimit të burimeve të të ardhurave për zonën funksionale, si dhe me njohjen dhe identifikimin e asetëve, pronave dhe territorit nën administrimin e saj. Njësitë ekzistuese vendore nuk do të jenë më operative. Stafi i Bashkisë së re mund të jetë potencialisht pa kualifikimin e nevojshëm për të realizuar operacione shkrirjesh të njësive administrative. Identifikimi i burimeve të të ardhurave, pronave dhe asetëve të Zonës Funksionale mund të shndërrohet në një proces të tejzgjatur, duke bërë të vështirë operimin e njësisë së re vendore dhe duke rrezikuar mundësitë e saj për të ofruar shërbime.

Konsolidimi fillestar i të gjitha aspekteve financiare dhe administrative të Zonës do të kërkojë ndihmë të specializuar, me qëllim futjen sa më shpejt në efikasitet të manaxhimit të ri të Zonës.

## Qëllimi/et specifik të projektit

Hartimi i një regjistri të konsoliduar asetesh për Zonën Funksionale, hartimi i pasqyrave financiare fillestare të konsoliduara, hartimi i një regjistri të konsoliduar të tokës dhe banesave, hartimi i një regjistri të konsoliduar të bizneseve dhe burimeve të tjera të të ardhurave vendore.

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- regjistër asetesh i konsoliduar për ZF,
- pasqyrave financiare fillestare të konsoliduara,
- regjistër i konsoliduar i tokës dhe banesave,
- regjistër i konsoliduar i bizneseve dhe burimeve të tjera të të ardhurave vendore.



## Aktivitetet e projektit

- Identifikim i të dhënave për çdo njësi vendore për secilin prej komponentëve të kërkuar.
- Verifikim me burime qendrore, në rastet kur është i mundur.
- Konsolidim i të dhënave në regjistra e pasqyra të konsoliduara.

## Maturimi i projektit

Aktualisht nuk ekziston asnjë ide për ofrimin e këtij shërbimi në Zonën Funksionale. Ministria e Çështjeve Vendore, nëpërmjet Projektit STAR, po bën pilotimin e kësaj asistence në dy zona funksionale të reja. Procesi ka rezultuar i vështirë dhe ka provuar nevojën për ekspertizë të mirëfilltë për kryerjen e tij. Autoritetet vendore ku po kryhet ky proces nuk kanë eksperiencën dhe kualifikimin e duhur për këtë stad. Njohja me eksperiencën e KPMG me dy zonat pilot dhe problemet e hasura nga Projekti STAR mund të shërbejnë për të përmirësuar mënyrën e adresimit të asistencës në Zonën Funksionale Malësi e Madhe.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Bashkia Malësi e Madhe  
DLDP

## Kostot e projektit

Kosto e vlerësuar e një asistence të tillë për Zonën Funksionale Malësi e Madhe është 20,000 Euro.